

20211031642

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË PËRMENDOREVE
MEMORIALE DHE SHENJAVE PËRKUJTIMORE**

Neni 1

Në Ligjin e Përmendoreve Memoriale dhe Shenjave Përkujtimore (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 66/04, 89/08 dhe 152/15), në kreun VII fjala “DISPOZITA” zëvendësohen me fjalët “SANKSIONE”.

Neni 2

Në nenin 28 në paragrafin 1 numri “5000” zëvendësohet me fjalët: “1.500 deri 3.000”.

Në paragrafin 2 fjalët: “30% nga gjoba e përcaktuar për personin juridik” zëvendësohen me fjalët: “250 deri 500 euro në kundërvlerë denari”.

Pas paragrafit 2 shtohet paragraf i ri 3, dhe bëhet:

“3 Për kundërvajtje sipas paragrafit (1) të këtij neni personit juridik dhe fizik mund t'i shqiptohet vërejtje në pajtim me Ligjin e Kundërvajtjes.

Në paragrafin 3, i cili bëhet paragraf 4 fjalët: “500 deri 750” zëvendësohen me fjalët: “50 deri 250”.

Paragrafët 4 dhe 5 bëhen paragrafë 5 dhe 6.

Neni 3

Në nenin 29 në paragrafin 1 numri “3000” zëvendësohet me fjalët: “1.000 deri 2.000”.

Në paragrafin 2 fjalët: “30% nga gjoba e përcaktuar për personin juridik” zëvendësohen me fjalët: “150 deri 250 euro në kundërvlerë denari”.

Në paragrafin 3 fjalët: “300 deri 450” zëvendësohen me fjalët: “150 deri 250”.

Pas paragrafit 3 shtohet paragraf i ri 4, dhe bëhen:

“4 Për kundërvajtje sipas paragrafit (1) të këtij neni personit juridik dhe fizik mund t'i shqiptohet vërejtje, në pajtim me Ligjin e Kundërvajtjes.

Neni 4

Në nenin 29-b paragrafët 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 fshihen.

Neni 5

Neni 29-v fshihet.

Neni 6

Në tërë tekstin e ligjit fjalët: “Republika e Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “Republika e Maqedonisë së Veriut”.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.